



# Taravari President **VLEN** Platforma presidencial



Arben Taravari  
**PROGRAM PËRBASHKUES**

## PËRMBAJTJA

MAQEDONIA E VERIUT NË UDHËKRYQ

5

MAQEDONIA E VERIUT E INTEGRUAR NË RAJON DHE NË EVROPË

6

MAQEDONIA E VERIUT PRODHUESE E SIGURISË

8

MAQEDONIA E VERIUT SHITËT I SË DREJTËS

10

MAQEDONIA E VERIUT DEMOKRACI KONSENSUALE

13

Taravari  
President  
**VLEN**



Tre funksionet kryesore të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë udhëheqja e politikës së jashtme, garantimi i sigurisë nacionale dhe i integritit territorial si Komandanti Suprem i forcave të armatosura, si dhe mbështetja e dialogut politik në funksion të kohezionit të brendshëm politik dhe shoqëror. Andaj, pozicioni i President kërkon një prijës përbashkues, i cili udhëhiqet nga vlerat.

Si kandidat për postin e Presidentit të Republikës, dua të lidh me ju një marrëveshje programore përbashkuese, për të cilën mbaj përgjegjësi dhe do të mund të më kërkonit llogari. Në këtë marrëveshje, paraqes para jush zotimet që dua t'i realizoj.

Maqedonia e Veriut është shtëpia jonë e përbashkët. Kjo shtëpi duhet të ketë shtylla të forta.

### Këto shtylla janë:

1.

**Integrimi në  
Bashkimin Evropian**

2.

**Siguria**

3.

**Shteti i  
së drejtës**

4.

**Demokracia  
konsensuale**

Politika ime e jashtme do të jetë e bazuar në vlerat evropiane dhe properëndimore. Si Komandanti Suprem, do të kujdesem për mbrojtjen tonë dhe avancimin e Sigurisë Rajonale. Si President që udhëhiqet nga vlerat, do të avancoj demokracinë konsensuale në shoqërinë tonë multi nacionale dhe multi kulturore.



# MAQEDONIA E VERIUT NË UDHËKRYQ



Maqedonia e Veriut është në udhëkryq. Vendi, rajoni dhe bota po përjetojnë një epokë krizash, trazirash dhe çrregullimesh.

Jashtë, lufta e agresionit rus kundër Ukrainës ka hapur një faqe të re në politikën ndërkombëtare dhe rajonale, me pasoja të thella për rendin botëror. Sistemi ndërkombëtar i bazuar në demokracinë, shtetin e së drejtës dhe bashkëpunimin shumëpalësh është nën kërcënim direkt. Të gjithë jemi dëshmitarë të rritjes së konkurrencës gjeopolitike, të proteksionizmit dhe fragmentimit ekonomik, si dhe të minimit të strukturave të rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë vijë e frontit në përplasjen gjeopolitike të Rusisë me Perëndimin, gjë që ka shtyrë shumicën e qeverive të rajonit të mbajnë qëndrim të qartë përkrah aleatëve tonë, Bashkimit Evropian (BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Megjithatë, matjet e opinionit tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve të rajonit, serbët në veçanti, por edhe një masë jo e neglizhueshme e bashkëqytetarëve maqedonas vazhdojnë ta konsiderojnë Rusinë si vend aleat. Përveç kësaj, të trimëruar nga përkrahja e Kremlinit, disa liderë rajonal janë shndërruar në vegla të Putinit dhe çënojnë hapur paqen dhe sigurinë rajonale. Siguria në Ballkan është e brishtë dhe ndaj kërkon përfshirje të shtuar të partnerëve tanë strategjik dhe bashkëpunim më të fuqishëm midis tyre.

Përbrenda, polarizimi është rritur dukshëm në shoqëri, si pasojë e një krize të trefishte ekonomike, politike dhe etike. Ende pa filluar mirë rimëkëmbja në dalje të pandemisë Covid-19, lufta në Ukrainë me pasojat e saj në çrregullimin e tregtisë së mallrave dhe në zinxhirët e furnizimit, ka shkaktuar inflacion të jashtëzakonshëm, duke rënduar edhe më tej bizneset dhe ekonominë familjare. Vendi poashtu po përballlet me një epidemi të korrupsionit që po e shtjerr besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Në fund, bllokimi i procesit të integritetit të vendit në BE, ka shkaktuar rritje të euroskepticizmit të një pjesë e bashkëqytetarëve dhe përhapje të narrativave anti-evropiane, të cilat ushqehen në masë të madhe nga ndikimet malinjë të Kremlinit, përmes fushatave të dezinformimit online dhe propaganduesve pro-rusë në Maqedoninë e Veriut.

Maqedonia e Veriut për fat të keq është bërë terren pjellor për forcat ektremiste që kanë për synim thellimin e ndasive në shoqërinë tonë multi kulturore, kultivimin e urrejtjes kundër BE-së, SHBA-ve dhe NATO-s, por edhe minimin e demokracisë liberale dhe konsensuale.

Sfida para nesh është jetike. Ne jemi gjenerata që duhet të sigurojmë që lufta e Putinit të mos i japë fund demokracisë perëndimore dhe të mos e ngadalësojë integritetin e vendit në BE.

Presidenti i ardhshëm i Republikës do të marrë detyrën në një botë ku rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla po dobësohet. Presidenti i ardhshëm do të marrë drejtimin e një vendi që duhet shëruar nga polarizimi dhe plagët e ekstremizmit.

*Presidenti do duhet të punojë për të ankoruar Maqedoninë e Veriut në Bashkimin Evropian, duke ulur tensionet e brendshme dhe duke kontribuar në luftimin e pakompromistë kundër epidemisë së korrupsionit. Andaj është koha që në krye të shtetit të vije një personalitet që e ka pastërtinë, kredibilitetin dhe guximin për t'u ngritur mbi politikën ditore dhe për të thyer balancet që kanë kontribuar në instalimin e kësaj gjendjeje.*

**MAQEDONIA E VERIUT  
E INTEGRUAR NË RAJON  
DHE NË EVROPË**



**Presidenti i Republikës është i pari midis katër organeve për udhëheqjen e politikës së jashtme, së bashku me Kuvendin, Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Si President, do të marr pjesë aktive në definimin e drejtimeve strategjike të vendit dhe në krijimin, përcaktimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut, si pjesë e pandashme e qytetërimit evropian dhe e demokracive liberale. Udhëheqja e politikës së jashtme të vendit do të bazohet në vlerat pro-perëndimore, të cilat duhet të mbrohen me ngulm në rrethanat aktuale gjeopolitike.**

Bashkimi Evropian është qëllimi ynë i padiskutueshëm. Integrimi evropian do të jetë objektivi kryesor i politikës së jashtme të vendit. Maqedonia e Veriut e integruar në BE është alternativa jonë e vetme dhe garanci për paqe, siguri, stabilitet, adresim të sfidave strukturore, rritje të qëndrueshme ekonomike dhe ruajtjen e rinisë sonë në vendlindje.

Maqedonia e Veriut dikur ishte vend lider në integrimin evropian. Ndërkohë që fqinjët kanë lëvizur me hapa të përshpejtuar drejt BE-së, Maqedonia e Veriut ka vend numëruar. Arsyet për ngecjen tonë janë të njohura: mungesa e vullnetit politik për të zbatuar reformat evropiane, korrupsioni dhe shovinizmi përballë kërkesave të BE-së.

Në mungesë të zbatimit të kushteve të përmbajtura në kornizën negociuese për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE, veçanërisht futjen e pakicës bullgare në premabulën e Kushtetutës, është më së e qartë se konferenca e parë ndërqeveritare e korrikut 2022 dhe përmbyllja e sukseshme e skringut do të ngelin letër e vdekur. Korniza negociuese është e patjetërsueshme dhe ndryshimet kushtetuese të paevitueshme.

Sfidat globale, si ndryshimi klimatik, revolucioni teknologjik apo demografia, nuk mund të zgjidhen në izolim. Nevojitet bashkëpunim ndërkombëtar për të dakorduar rregulla dhe veprime të koordinuara për të trajtuar sfidat bashkarisht, në kuadër të institucioneve ekzistuese ndërkombëtare.

Politika e jashtme do të bazohet në parimet e paqes, marrëdhëniesve të mira fqinjësore, rritjen e bashkëpunimit rajonal, multilateralizmin aktiv dhe respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare. Mosmarrëveshjet midis Presidentit, Qeverisë dhe

Kuvendit për prioritetet e politikës së jashtme dhe koordinimi i dobët midis tyre nganjëherë kanë bërë që të humbasim kredibilitetin në sytë e aleatëve tanë. Maqedonia e Veriut do të udhëheqë një politikë pro-perëndimore në proceset globale dhe do ta forcojë pozitën e saj në bashkëpunimet rajonale si dhe do të rrisë integrimin e mërgatës në shtet. Politika e jashtme do të udhëhiqet në mënyrë harmonike dhe të parashikueshme ndaj partnerëve tanë.

Për sa kohë që Rusia vazhdon me agresionin e saj ushtarak në Ukrainë dhe me destabilizimin e Ballkanit Perëndimor, ne nuk do të kemi bashkëpunim me Rusinë. Veprimet tona do të përcaktohen nga politikat e përbashkëta me aleatët tanë në BE dhe NATO.

Në rajon, do të bashkëpunojmë në bazë të vlerave tona. Një ndër to është mbështetja e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Nga kjo rrjedh se Maqedonia e Veriut nuk do të marrë pjesë në nismat rajonale ku Kosova nuk është në tavolinë si partnere e barabartë. Nisma Ballkani i Hapur është përkrahur nga diplomacia ruse si instrument për të promovuar hegjemoninë politike dhe ekonomike të Kremlinit në rajon, përmes Serbisë ku lulëzojnë ndjenjat pro-ruse dhe interesat ruse. Që nga fillimi i agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, në Serbi janë regjistruar mbi 300 kompani ruse, ku më shumë se gjysma prej tyre janë kompani aktive në fushën e IT-së të cilat në mënyrë direkte apo indirekte bashkëpunojnë me kompani nga Maqedonia e Veriut, duke penetruar kështu në ekonominë e vendit. Andaj, nismën Ballkani i Hapur e shohim si konkurrente me NATO-n dhe me BE-në.

## Zotimet e mia:

- Do të bashkërendojë përpjekjet me faktorin ndërkombëtar për të siguruar zotim nga përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikën e jashtme se pas ndryshimeve kushtetuese nuk do të ketë kërkesa të reja ndaj Maqedonisë së Veriut jashtë kornizës negociuese të vitit 2022.
- Mandatin për formimin e Qeverisë së ardhshme do t'ia besoj kandidatit të partisë, përkatësisht partive, që dëshmon se ka shumicë në Kuvend, duke kërkuar nga mandatarin dorëzimin në Kuvend të një plani të afatshkur për realizimin e ndryshimeve kushtetuese të nevojshme për vazhdimin e rrugës evropiane të vendit.
- Me qëllim të forcimit të përpjekjeve për anëtarësimin e vendit në BE, do të ngris bashkëpunimin dhe do të punoj ngushtë me Kuvendin për të inicuar dhe lehtësuar miratimin e ligjeve dhe të reformave që dalin nga standardet dhe kërkesat e BE-së, prioritet në fushën e shtetit të së drejtës, administratës publike, digjitalizimit, të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes.
- Bazuar në nenin 121 të Kushtetutës, do t'i propozoj Kuvendit daljen e menjëhershme të Maqedonisë së Veriut nga nisma Ballkani i Hapur, për sa kohë Serbia nuk i zbaton në plotni dhe në mirëbesim marrëveshjet e Brukselit dhe Marrëveshjen e Ohrit të vitit 2023 për normalizimin e raporteve me Republikën e Kosovës, të arritura në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe mbështetur nga SHBA-të.
- Do të përkrahi mekanizmat ndërqeveritare për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës dhe të Marrëveshjes së Miqësisë me Bullgarinë për të shmangur tensionet e mundshme dhe ndihmuar në adresimin e implikimeve të tyre të jashtme dhe të brendshme.
- Do të lehtësoj përgatitjen dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse shtetërore për angazhim më të madh diplomatik në rajon, duke u fokusuar në bashkëpunimin rajonal ekonomik, arsimor, kulturor, si dhe në inovacion dhe digjitalizim.
- Do të angazhohem për harmonizim të plotë të politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së në të gjitha fushat, veçanërisht në lidhje me sanksionet e BE-së, luftën kundër terrorizmit, sulmet kibernetike, ruajtjen e kufijve të përbashkët dhe migrimin.
- Do të organizoj samit diplomatik vjetor në bashkëpunim me me aleatët tonë kryesorë, për të forcuar partneritetet dhe për të nxitur bashkëpunimin në çështjet që lidhen me interesat e shteteve të regjionit.
- Do të përgatis një strategji presidenciale për të promovuar investimet e huaja, përfshirë krijimin e një departamenti në Presidencë që do të merit ekskluzivisht me tërheqjen e investimeve të huaja, duke organizuar misionet ekonomike të Presidentit dhe duke bashkërenduar aktivitetet me organet shtetërore gjegjëse.
- Personalitete të veçanta nga jeta publike dhe sipërmarrësve të mërgatës do të emërohen në pozitën e Konsullit të Nderit në vendet përkatëse, për të ndikuar kështu në përmirësimin e imazhit të vendit dhe komunikimit gjithëpërfshirës të mërgatës sonë me shtetet përkatëse.

**Si President i Republikës, premtoj se do të punoj për të siguruar që Maqedonia e Veriut të ndjekë një politikë të jashtme të bazuar në vlera dhe që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian në horizontin 2030.**

## MAQEDONIA E VERIUT PRODHUESE E SIGURISË

BE, SHBA dhe NATO janë aleatët tanë të pazëvendësueshëm. Si partner i besueshëm, ne bashkëpunojmë ngushtë me ta dhe jemi të gatshëm të luajmë rolin tonë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë përkrah tyre. Siguria jonë është e përbashkët. Maqedonia e Veriut nuk konsumon siguri, ne prodhojmë siguri.





NATO ka qenë në Ballkanin Perëndimor dhe Ballkani Perëndimor ka qenë në NATO që nga vitet 1990, përmes operacioneve, partneritetit dhe anëtarësimit në Aleancë, tanimë të fituar nga shumë vende të rajonit.

Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë anëtare të plota të NATO-s. Rusia punoi me këmbëngulje si me mjete të fshehta ashtu edhe me metoda të hapura për të bllokuar pranimin e vendit tonë në NATO, por përfundimisht dështoi në ato përpjekje falë urtësisë së faktorit politik vendor dhe përkrahjes së aleatëve tanë.

Maqedonia e Veriut nuk përballet me asnjë kërcënim të drejtpërdrejtë të jashtëm për momentin. Por kjo nuk do të thotë se Rusia nuk përbën kërcënim. Ajo do të vazhdojë të nxisë frikë dhe të krijojë destabilitet. Siguria jonë e jashtme garantohehet nga anëtarësimi ynë në NATO dhe bashkëpunimi i mbrojtjes me SHBA-të. Ne nuk jemi të vetëm, por megjithatë kujdesemi për sigurinë tonë.

Si vend anëtar, ne jemi të përkushtuar për të kontribuar në zbatimin e konceptit strategjik të NATO-s, që ka për synim kryesor mbrojtjen kolektive të anëtarëve të saj, bazuar në qasjen 360 shkallë dhe në shtyllat themelore: dekurajim dhe mbrojtje, parandalim dhe menaxhim i krizave, si dhe siguri bashkëpunuese. Ne jemi të përkushtuar ndaj politikës së dyerve të hapura të NATO-s dhe do të vazhdojmë të forcojmë partneritetin tonë me Ukrainën në rrugën e saj drejt integritetit euro-atlantike.

Në përputhje me obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO, ne do të investojmë vazhdimisht në sigurinë dhe stabilitetin euroatlantik, duke ndërtuar kapacitetet tona mbi parimin e solidaritetit dhe marrëdhënie të forta transatlantike.

Strategjia jonë e mbrojtjes do të synojë ndër tjera rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të mbrojtjes, promovimin e pozicioneve dhe zhvillimin e aftësive të reja të nevojshme për funksionimin efektiv dhe efikas të sistemit, si dhe sinkronizimin dhe avancimin e planit të mbrojtjes në përputhje me standardet e NATO-s dhe BE-së. Poashtu synojmë efektivitet më të madh dhe shfrytëzim racional të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, si dhe rritje të ndërgjegjësimit dhe besimit në popullatë për rëndësinë e sistemit të mbrojtjes në zhvillimin e një shoqërie demokratike.

Maqedonia e Veriut do të vazhdojë të kontribuojë në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në rajon dhe në botë, përmes pjesëmarrjes aktive në operacionet paqeruajtëse, operacionet për menaxhim të krizave dhe për siguri bashkëpunuese të partnerëve tanë ndërkombëtarë. Për të kontribuar në të gjithë spektrin e operacioneve dhe misioneve të udhëhequra nga NATO-ja, Maqedonia e Veriut do të mbajë efektive ushtarake të dislokueshme në nivelin prej 50% të strukturës së përgjithshme të forcave tokësore shumëfunksionale. Në planin afatgjatë, do të marrim pjesë në operacione ndërkombëtare me efektive dhe personel ushtarak që gradualisht do të rriten në 10% të strukturës së përgjithshme të Armatës.

Për sa i përket aviacionit, ne jemi realistë. Resurset e kufizuara të Maqedonisë së Veriut pamundësojnë ndjekjen e trendeve moderne në aviacion dhe imponojnë maksimizimin e bashkëpunimit rajonal të mbrojtjes me vendet e Evropës Juglindore anëtare të NATO-s.

Siguria megjithatë nuk përfaqëson vetëm aftësitë ushtarake, por përfshinë edhe përpjekjet politike, menaxhimin e komponentëve dhe kapaciteteve ekonomiko-energjetike dhe teknologjike për mbrojtjen e mjedisit njerëzor. Prandaj duhet të mendojmë edhe për aspekte të tjera të sigurisë. Siguria kibernetike për shembull duhet të jetë pjesë e mbrojtjes sonë.

Si President, do të avokoj për miratimin e ligjeve që përmirësojnë mbrojtjen kibernetike, promovojnë shkëmbimin e informacionit midis agjencive qeveritare dhe sektorit privatë, investojnë në programet e edukimit dhe trajnimit për sigurinë kibernetike dhe vendosin protokolle të fuqishme të reagimit ndaj incidenteve. Për më tepër, bashkëpunimi me palët përkatëse të interesit si ekspertët e sigurisë kibernetike, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe kompanitë e teknologjisë do të forcojnë sigurinë kibernetike të shtetit.

Inovacioni është sektor kyç për sigurinë dhe zhvillimin e vendit. Presidenca do të jetë në përkrahje të plotë të të rinjëve dhe të rejave tona që mund të bëjnë Maqedoninë e Veriut të së nesërme.


Do të angazhohem për krijimin e shkollave për inovacion të menaxhuara nga zyra e Presidentit. Do të angazhohem për rritjen e investimeve publike dhe private në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), krijimin e një çmimi presidencial për inovacion si dhe një çmimi presidencial për startups dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme më inovative të vitit.

Sa i përket ndikimit energjetik të Moskës, nga 100% sa ka qenë deri më tani për gazin natyror, duhet të angazhohemi të ulim në zero varësinë tonë energjetike nga Rusia, ndër tjera duke shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet e sistemeve alternative të furnizimit.

Sigurisë do t'i qasem edhe si koncept njerëzor sepse familjet tona kanë nevojë për siguri. Siguria njerëzore nënkupton domosdoshmërinë që njerëzit të jetojnë në liri dhe dinjitet, që të mund të gëzojnë lirisht të drejtat e tyre dhe të zhvillojnë potencialin e tyre njerëzor. Vetëm një shtet pa korrupsion, me një sistem drejtësie që ndëshkon kriminelin dhe mbron me kujdes viktimën, mund të jetë një shtet i drejtë dhe i sigurtë.

## Zotimet e mia:

- Maqedonia e Veriut, do të sigurojë buxhet të qëndrueshëm shumëvjeçar të mbrojtjes në nivelin prej 2% të produktit të brendshëm bruto, si parakusht i domosdoshëm për planifikim efektiv dhe afatgjatë të mbrojtjes, zhvillimin e aftësive të reja dhe modernizimin e forcave, në përputhje me kriteret e NATO-s.
- Fondet e buxhetit të mbrojtjes do shfrytëzohen në mënyrë optimale duke u ndarë si vijon: deri në 50% për shpenzimet e personelit, deri në 30% për kostot e operacioneve, mirëmbajtjes dhe trajnimit, si dhe deri në 20% për kostot e pajisjeve dhe modernizimit. Kjo do të mundësojë arritjen e qëllimeve të mbrojtjes dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja, të nevojshme për përballimin e sfidave të sigurisë.
- Aftësitë mbrojtëse do të rihartohen në mënyrë që gradualisht të reduktohet personeli dhe të zëvendësohen pajisjet e vjetëruara me pajisje të sofistikuar, në përputhje me standardet e NATO-s. Ministria e Mbrojtjes dhe Armata do të reformohen dhe do të racionalizohen, sipas rekomandimit të NATO-s për 650–700 të punësuar në administratë dhe 6,800 trupa, duke u kujdesur gjithashtu edhe për arritjen e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat që çalon në këtë sektorin e mbrojtjes.
- Do të konsolidohen komandat dhe njësitë e Armatës në lokacione më të vogla për të zvogëluar infrastrukturën e tepërt. Kështu do të sigurohen burime financiare shtesë për rinovimin dhe modernizimin e infrastrukturës, si dhe për përmirësimin kushteve të punës dhe të jetesës së personelit të mbrojtjes.
- Do të angazhohem për të rritur kontributin tonë në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së, në misionet dhe operacionet paqeruajtëse të BE-së në botë, si dhe për të forcuar rolin e vendit në strukturat rajonale të sigurisë. Këtu, kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit rajonal me shtetet e tjera anëtare të NATO-s dhe me Republikën e Kosovës në rrafshin e stërvitjeve të përbashkëta dhe të mobilitetit akademik.
- Në kuadër të kompetencave të Presidentit për emërimet në Armatë dhe në Agjencinë e Zbulimit, do të kujdesem që zyrarët në fjalë të jenë profesionistët më të mirë dhe më të dëshmuar, por që edhe e kaluara e tyre të jetë në përputhje të plotë me parimet e demokracisë liberale dhe vlerat pro-perëndimore për të cilat ne qëndrojmë si vend.
- Do të ndihmoj që t'i japim fund varësisë sonë energjetike nga Rusia. Synimi im do të jetë diversifikimi i burimeve të energjisë në të gjitha nivelet, që është rruga më e mirë drejt sigurisë dhe stabilitetit. Për këtë qëllim, do të sjell ekspertë – akademikë, ekspertë të energjisë, ekonomistë dhe ekologë – në një tryezë dhe do të ndihmoj në formulimin një koncepti shtetëror të energjisë.
- Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit rajonal rreth sfidave të përbashkëta të sigurisë si terrorizmi, krimi i organizuar dhe migrimi i paligjshëm, do të organizojmë trjanimet rajonale, hakatone dhe seminare me çka do të përmisojmë shkëmbimin e informacionit, krijimin e mundësive për operacione të përbashkëta dhe nisma tjera për ngritjen e kapaciteteve.
- Inovacioni është sektor kyç për sigurinë dhe zhvillimin e vendit. Presidenca do të jetë në përkrahje të plotë të rinjve dhe të rejave tona që mund të bëjnë Maqedoninë e Veriut të së nesërme. Do të angazhohem për krijimin e shkollave për inovacion të menaxhuara nga zyra e Presidentit. Do të angazhohem për rritjen e investimeve publike dhe private në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), krijimin e një çmimi presidencial për inovacion si dhe një çmimi presidencial për startups dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme më inovative të vitit.
- Do të krijoj një Task Force për siguri kibernetike të përbërë nga përfaqësues të agjencive përkatëse qeveritare, ministrive përkatëse si dhe ekspertë të industrisë. Kjo Task Force do të ndihmojë edhe në ngritjen e një protokoli për koordinim ndër-institucional për të rritur aftësitë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kibernetike. Ajo gjithashtu do të ndihmojë në nxitjen e partneriteteve ndërkombëtare për të shkëmbyer informata, me qëllim koordinimin e përgjigjeve ndaj kërcënimeve kibernetike lokale dhe globale.
- Do të zbatoj një fushatë ndërgjegjësimi publik për të edukuar qytetarët rreth praktikave më të mira të sigurisë kibernetike, dhe do të bashkëpunoj me institucionet për të promovuar sigurinë kibernetike, ndër tjezar duke ndarë një çmim presidencial për të rinjtë që promovojnë sigurinë kibernetike në vend.



Si President i Republikës, premtoj të bëj gjithçka në fuqinë time për ta bërë Maqedoninë e Veriut një vend të sigurtë. Do të siguroj që Maqedonia e Veriut do të promovojë paqen dhe stabilitetin rajonal. Do të kujdesem që të kemi aftësi kredibile dhe moderne mbrojtëse si pjesë e obligimeve tona në NATO dhe në BE. Si Komandant Suprem, premtoj që Armata do të jetë transparente, llogaridhënëse dhe përfaqësuese e diversitetit të shoqërisë sonë.

# Voto

# 6

# MAQEDONIA E VERIUT SHTETI I SË DREJTËS



Presidenti i Republikës është një prijës i bazuar në vlera. Shteti i së drejtës garanton demokracinë dhe është jetik në luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e lirisë së mediave, promovimin e të drejtave të njeriut dhe mbështetjen e një mjedisi të favorshëm për biznesin dhe investitorët. Presidenti luan rol vendimtar në garantimin e respektit të plotë për shtetin e së drejtës, si dhe në mbështetjen dhe promovimin e tij.

Sistemi politik i korruptuar është armiku ynë numër një, frenuesi më i madh për zhvillimin e Maqedonisë e Veriut dhe mirëqenien e qytetarëve, por edhe penguesi kryesor për integrimin evropian të vendit tonë.

Procesi i integritetit evropian është burim i rëndësishëm i stabilitetit nga jashtë por, deri më tani, te ne, ky proces ka dështuar në materializimin e narracionit thelbësor të evropianizimit përbrenda – një transformim shoqëror, politik dhe ekonomik i nxitur nga perspektiva e anëtarësimit në BE.

Projekti i integritetit të Maqedonisë së Veriut në BE duhet patjetër të pasqyrohet në standardin e jetesës së qytetarëve, në ndërtimin dhe afirmimin e vlerave shoqërore evropiane, si dhe në funksionimin e institucioneve shtetërore. Nëse kjo nuk ndodhë, procesi i integritetit rrezikon të sjellë zhgënjim dhe rënie të mbështetjes së qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin në BE.

Qysh në shtatorin e vitit 2017, Grupi i Ekspertëve të Lartë të BE-së për çështjet sistematike të sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut (grupi Priebe), kishte tërhequr vërejtjen se gabimet e së kaluarës në vendin tonë nuk duhet të përsëriten. Grupi Priebe kërkonte të mos lejohet që një formë e kapjes së shtetit të zëvendësohet me një tjetër.

Fatkeqësisht, edhe përkundër investimeve nga partnerët tonë në reforma dhe ligje të reja, ky paralajmërim tanimë është shndërruar në profeci vetë përbushëse. Procesi i integritetit evropian po vazhdon të jetë i fokusuar në reforma kryesisht teknike dhe po dështon të prodhojë kohezion në shtetin e së drejtës midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së.

Pasqyra e përgjithshme është e zymtë. Gjyqësori kurrë nuk ka qenë më i kapur dhe më jofunksional, me shumicën dërrmuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë vetë të korruptuar dhe nën kontrollin e politikës.

Thellimi i pandëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, veçanërisht pas ndryshimeve të Kodit Penal të vitit 2023, por dhe drejtësia selektive në rastet e montuara politike kanë sjell një gjendje ku vetëm 2% e qytetarëve i besojnë drejtësisë.

Financimi adekuat i organeve për zbatimin e ligjit dhe parandalimin e korrupsionit është komponent thelbësor i një sistemi të pavarur, efektiv dhe efikas dhe parakusht për shtetin e së drejtës. Nivelet aktuale të financimit – 37.7 milionë euro për sistemin gjyqësor, 10.8 milionë euro për Prokurorinë Publike apo 0,9 milionë euro për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në buxhetin e vitit 2022 – sqarojnë në masë të madhe paaftësinë e këtyre institucioneve për të përbushur obligimet e tyre. Për shembull, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2022 kishte vetëm 34 të punësuar nga 64 sa janë të planifikuar dhe Prokuroria Publike numëronte vetëm 170 prokurorë gjithsej, apo një deficit prej 82 prokurorëve për të arritur në mesatarën e rekomanduar nga Këshili i Evropës (nëntë për 100,000 banorë).

Sistemi jonë i drejtësisë dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit, në esencë, janë në gjendje të vdekjes klinike. Ato kanë nevojë për reformim të tërësishëm.



## Zotimet e mia:

- Do t'i kërkoj Kuvendit sjelljen e një pakoje legjislativë për reformimin e tërësishëm të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Kjo pako duhet të përmbajë ligjin për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, reformimin e sistemit për zgjedhjen, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, si dhe digjitalizimin e plotë të gjykatave në përputhje me Kornizën Strategjike të Këshillit të Evropës.
- Do të shtyj përpara idenë e themelimit të Komisionit për Standardet në Jetën Publike, bazuar në përvojën e Mbretërisë së Bashkuar. Ky trup do të ketë për synim promovimin e etikës dhe moralit në jetën publike, më konkretisht duke i promovuar 7 parimet e Nolanit për Jetën Publike: vetëmohimi, integriteti, objektiviteti, llogaridhënia, transparencja, ndershmëria dhe lidërshtipi. Komisioni do të shërbejë si organ këshillimor i Presidentit dhe organeve shtetërore përgjegjëse për shtetin e së drejtës. Komisioni do të jetë trup i pavarur që i përgjigjet Parlamentit. Kryetari i Komisionit do të zgjidhet në Kuvend dhe Komisioni do të ketë buxhetin e vetë të pavarur nga organet tjera.
- Do të angazhohem për dyfishim të investimeve publike në gjyqësor, në prokurorinë publike dhe në institucionet përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit, me prioritet të veçantë për këto organe: Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Departamenti o Specializuar për Gjykimin e Veprave nga Sfera e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Byroja e Sigurisë Publike, Enti Shtetëror i Revizionit dhe qendrat tjera hetimore, si dhe njësitë për zbatimin e ligjit të ngarkuara me hetimin e korrupsionit. Në planin afatmesëm, nevojiten reforma ligjore për të siguruar që përgatitja e buxhetit për gjyqësorin dhe institucionet kundër korrupsionit, të jetë tërësishme ose të paktën pjesërisht nën kontrollin e organeve të pavarura dhe autonome dhe jo të qeverisë, nga faza e përgatitjes së projekt buxhetit e deri në miratimin e tij nga ana e Kuvendit. Kjo do të garantojë se buxheti i këtyre institucioneve do të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet politike.
- Do të angazhohem për anulimin e ndryshimeve të Kodit Penal të vitit 2023 që ishin anti evropiane dhe të dëmshme në luftën kundër korrupsionit. Ndryshimi i neneve 353, 353-v dhe 394 ka ndikuar në rritjen e pandëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, duke pamundësuar ndekjen penale ose vuajtjen e dënimit. Kjo bie ndesh me obligimet e Maqedonisë së Veriut si shtet kandidat për anëtarësim në BE. Kodi Penal duhet të ndryshohet sërish për të garantuar përputhje me legjislacionin evropian kundër korrupsionit dhe praktikën e shteteve anëtare.
- Do të propozoj për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor, vetëm profesionistët më të mirë, me integritetin më të lartë të mundshëm moral dhe që kanë dëshmuar vlerat e tyre pro-evropiane.
- Do të shfrytëzoj kompetencat e mia për falje presidenciale për t'i dhënë fund drejtësisë selektive në rastet e montuara politike.
- Si President i Republikës, zotohem se nuk do të dekretoj shpalljen e ligjeve laksiste që e largojnë edhe më tej vendin nga normat evropiane siç ka ndodhur në të kaluarën.
- Në aspekt të administratës publike do të angazhohem për reforma në sektorin publik edhe atë duke kërkuar reduktimin e burokracisë dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nëpërmjet iniciativave të qeverisjes elektronike, digjitalizimit të proceseve si dhe sistemeve të menaxhimit të bazuar në performancë.

Si President i Republikës, do të luftoj më tërë qenien time korrupsionit e sistemit politik dhe do të ndërmarr hapa konkret për rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Prioritet e mia kryesore në këtë rrafsh janë ndërtimi i një gjyqësori të pavarur, efektiv dhe të drejtë, çrënjosja e korrupsionit, një administratë e depolitizuar dhe meritokratike, si dhe mbështetja e qytetarëve për t'u përfshirë në debatin publik përmes qasjes universale në informacion.

Ndryshimi

**VLEN**

**MAQEDONIA E VERIUT  
DEMOKRACI KONSENSUALE**



Maqedonia e Veriut është në udhëkryq. Kriza e trefishtë ekonomike, politike dhe etike ka polarizuar shoqërinë, duke ndikuar në thellimin e ndasive, rritjen e euroskepticizmit, forcimin e narrativave ekstremiste dhe minimin e demokracisë liberale dhe konsensuale. Duhet të tejkalojmë edhe këtë sfidë, siç i kemi tejkaluar kthesat historike në tre dekadat e mëvetësisë. Nga ky tranzicion duhet të dalim si një vend i bashkuar.

Pa dyshim, operacionet e ndikimit rus që synojnë të krijojnë përçarje brenda shoqërisë sonë dhe të gërryjnë besimin në institucionet e shtetit janë përgjegjëse për këtë gjendje. Mediat e kontrolluara nga Kremli, organizatat e shoqërisë civile dhe politikantët e lidhur me interesat ruse i kanë kontribuar këtij ndikimi malinj që ka për qëllim minimin e integritetit të Maqedonisë së Veriut në strukturat euro-atlantike.

Jam i shqetësuar për thellimin e ndasive në shoqërinë tonë multi kulturore, por edhe për pasojat e këtyre ndasive në sigurinë tonë të brendshme. Një shoqëri e ndarë nuk mund të mbrohet. Përkundrazi, aty ekziston rreziku për destabilizim të brendshëm.

Me vizion të përcaktuar nga parime e ideale të patundshme, le të punojmë për afirmimin dhe thellimin e demokracisë konsensuale, në frymën e Arbën Xhaferit, i cili ishte dhe vazhdon të ngelet udhërrëfyesi im politik. Arbëni qysh në vitin 1999 fliste për një reduksionizëm permanent në Maqedoninë Veriut, duke vënë në pah se Kushtetuta është me e ngushtë se realiteti, pastaj atë çka e lejon Kushtetuta e ngushton ligji, atë që e lejon ligji e ngushton institucioni, atë që e lejon institucioni nuk e realizon individi.

Fatqëqësisht, 25 vite më vonë, në disa segmente jemi po aty, te reduksionizmi permanent i Arbën Xhaferit. Kushtetua ende i referohet gjuhës shqipe në mënyrë fyese si gjuha zyrtare e folur nga 20% e popullatës dhe që dallon nga maqedonishtja. Ligji parashih zbatim vetëm të pjesshëm gjeografikisht dhe institucionalisht meqë ai liston vendet ku shqipja është gjuhë zyrtare. I njëjti konstatim vlenë edhe për parimin kushtetues për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat. Ligji për punonjësit e sektorit publik shkel me dy këmbë Kushtetutën duke përjashtuar nga fushëveprimtaria e parimit të përfaqësimit të drejtë institucionet në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke nënkuptuar kështu se një pjesë e madhe e qytetarëve të këtij vendi nuk janë lojal apo të besueshëm mjaftueshëm për të punuar apo udhëhequr me këta sektorë.

Mendoj se është jetike që të mbrojmë dhe të avancojmë vlerat që e kanë bërë Maqedoninë e Veriut një vend model në sytë e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Le të jemi krenarë për atë që kemi arritur së bashku. Vetëm së bashku do të kemi sukses. Jo kundër njëri tjetrit, por gjithmonë me njëri tjetrin. Le të dëshmojmë se demokracia konsensuale dhe liberale, barazia, shteti i së drejtës dhe ekonomia e tregut janë gurë themelët e shoqërisë sonë multi nacionale dhe multi kulturore.

Nuk duhet të fokusohemi në atë që na ndan, por në atë që na bashkon. Nuk do të lejojmë të polarizohemi në të majtë dhe të djathtë, euro-entuziastë dhe euro-skeptikë, pro-perëndimorë dhe pro-rusë, të rinj dhe të moshuar, maqedonas dhe shqiptarë. Në vend që të mbyllemi në identitetet tona, duhet të punojmë bashkë për më tepër mirëbesim dhe kohezion.

Si President, dua t'i adresoj këto çështje. Madje do të anagazhohem për të sjellur edhe vetë institucionin e Presidentit në kornizat e demokracisë konsensuale në frymën e Marrëveshjes së Ohrit, që Presidenti të jetë vërtetë garantues i unitetit të popullit dhe simbol i vlerave demokratike.

**Si President i Republikës, premtoj se do të mbroj demokracinë konsensuale, lirinë e shprehjes dhe shtetin e së drejtës në të gjitha situatat. Do të dëgjoj, do të diskutoj dhe do të kujdesem për secilin dhe secilën. Si President, premtoj të jem faktor përbashkues dhe të punoj në interesin më të mirë të të gjithë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.**

## Zotimet e mia:

- Me ndryshimin e ardhshëm të Kushtetutës, do të kërkoj që zgjedhja e Presidentit të bëhet në Kuvend përmes mekanizmit të shumicës së dyfishtë, në mënyrë që Presidenti të jetë përfaqësues i unitetit popullor. Idealisht, zgjedhja e Presidentit do të bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë Maqedoninë e Veriut. Por nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, do të parashihet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë. President do të zgjedhet kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe shumicën e votave të deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë.
- Do të kujdesem për avancimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat e të gjitha komuniteteve në rritjen diplomatik të vendit, në Armatë dhe në sektorin e sigurisë, në gjyqësor dhe në sektorët tjerë ku Presidenti ka të drejtë propozimi apo emërimi, çdoherë duke respektuar parimet e depolitizimit, mosdiskriminimit dhe meritokracisë.
- Në bashkëpunim me organizatat qytetare dhe mediat, do të ndërmarr nismë presidenciale për të luftuar për Lirinë e Medias dhe në veçanti dezinformimin pro-rus. Do të mbyllem mediat ruse dhe ato të financuara nga Rusia, gjithnjë duke u kujdesur për respektimin e të drejtës për lirinë e shprehjes dhe të informacionit.
- Do të kujdesem që nga Kushtetuta të eliminohet përkufizimi fyese i gjuhës shqipe si "gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve" dhe që gjuha shqipe, në alfabetin e saj, të jetë gjuhë zyrtare në tërë territorin e Republikës në nivel të barabartë me gjuhën maqedonase.

*Një prej burrave më të rëndësishëm të historisë evropiane dhe botërore, Konrad Adenauer ka thënë:  
- Kur të gjithë të tjerët meqojnë se është fundi, Ne duhet të fillojmë!  
Le të jetë ky një fillim i ri!*



# Taravari President

# VLEN

Platforma presidenciale

  
ALEANCA për SHQIPTARËT

  
ALTERNATIVA

  
LËVIZJA  
BESA

  
LËVIZJA  
DEMOKRATIKE